

## **AKTI I THEMELIMIT I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "Izonode" SH.P.K**

Sot më 26.04.2022 u paraqitën palët e mëposhtme :

- Ahmed Pemaj, lindur në Tiranë më 18.09.2002, me numër personal K20918044F.
- Orhan Asllani, lindur në Pukë më 13.11.2003, me numër personal K31113046V.
- Erald Dega, lindur në Koçanaj më 29.07.2003, me numër personal K30729049D.
- Daniel Doci, lindur në Tirane më 29.07.2003, me numër personal K30729088A.

Të cilat kanë vendosur të nënshkruajnë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti së cilës i bashkëngjitet.

### **NENI 1 – EMËRTIMI**

Emërtimi i shoqërisë është "Izonode" Sh.p.k

### **NENI 2 – SELIA**

Selia e shoqërisë është në Tirane, Rruga Shyqyri Ishmi P 79/1, Sh.1, Kati 3, Ap 8.

### **NENI 3 – KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

### **NENI 4 – SUBJEKTI I SHOQËRISË**

4.1 Shoqëria do të merret me çdo lloj aktiviteti tregtar të lejuar nga legjislacioni Shqipëtar.

4.2 Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë sipas nenit 3.1 të statutit apo nenit 4.1 të Aktit të Themelimit.

### **NENI 5 – KAPITALI THEMELTAR**

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 1000000 lekë.

5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 4 kuota, të gjitha të nënshkruara me vlerë nominale sipas kontributit të ortakëve në kapitalin themeltar të shoqërisë përcaktuar në nenin 7 të statutit të saj.

### **NENI 6 – KONTRIBUTET**

6.1 Kontributi në kapitalin themeltar të shoqërisë është ofruar si më poshtë:

- Ahmed Pemaj ofron një kontribut në para të barabartë me 333300 lekë.
- Orhan Asllani ofron një kontribut në para të barabartë me 333400 lekë.
- Erald Dega ofron një kontribut në para të barabartë me 166650 lekë.
- Daniel Doci ofron një kontribut në para të barabartë me 166650 lekë.



6.2 Sipas kontributeve të mësipërme :

- Personit Ahmed Pemaj i përket nje kuote me vlerë nominale 333300 lekë që korrespondon me 33.33% të kapitalit të shoqërisë.
- Personit Orhan Asllani i përket një kuotë me vlerë nominale 333400 lekë që korrespondon me 33.34% të kapitalit të shoqërisë.
- Personit Daniel Doci i përket një kuotë me vlerë nominale 166650 lekë që korrespondon me 16.665% të kapitalit të shoqërisë.
- Personit Erald Dega i përket një kuotë me vlerë nominale 166650 lekë që korrespondon me 16.665% të kapitalit të shoqërisë.

#### NENI 7 – TRANSFERIMI I KUOTAVE

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të statutit.

#### NENI 8 – ADMINISTRIMI

8.1 Me këtë akt emërohet një administrator i shoqërisë, si më poshtë :

- Z. Ahmed Pemaj, djali i Armir Pemaj, lindur më 18.09.2002, me numër personal K20918044F.

8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe nenit 14 të statutit.

8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim administratori mund tu drejtohet për ndihmë palëve të treta për cilëndo çështje e cila ka të bëjë me veprimtarinë e shoqërisë.

8.4 Administratori është i autorizuar të veprojë në emër të shoqërisë në formim e sipër, deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Ai është i autorizuar të firmosë të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë ti delegojë kompetencat e tij, personave të tjerë.


Tiranë më 26.04.2022

#### ORTAKËT


AHMED PEMAJ



ORHAN ASLLANI



DANIEL DOCI



ERALD DEGA

